

Data __. __. 2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirembajtje Full risk të aparaturave të prodhuesit GE Healthcare”
- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat
24 muaj**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 50421000-2 Shërbime
për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 19,209,000 (Nëntëmbëdhjetë milionë e dyqind e nëntë mijë) Lekë pa
Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitali Universitar i Traumës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Lista e cmimeve të zerave, sipas Shtojcës 2;*
- c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- d. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 27 dhe nenin 26, pika 2, germa “e”, nenin 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Operatori ekonomik fitues duhet të jetë i pajisur me:

b) Operatori ekonomik fitues duhet të jetë i pajisur me: “Autorizim për tregtim me shumicë të pajisjeve mjekësore” të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë - Çertifikatë ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë në mirembajtjen e aparaturave mjekesore, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot., date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot., date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme

të ngjashme të jenë në vlerën në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

b) Të ketë të paktën tre specialistë të lartë në fushën e teknikës Bio-mjekesore (inxhinier biomedical/elektronik/informatic/elektrik ose fusha të ngjashme) për mirëmbajtjen e aparaturave objekt të këtij prokurimi, ku të paktën njeri prej tyre të jetë trajnuar dhe certifikuar për pajisjet e markës GE sipas specifikimeve teknike të pershkuara në shtojcën nr. 5.

Për të vërtetuar këtë, OE duhet të paraqesin CV e specialistëve dhe certifikatat /dëshmitë e trajnimit lëshuar nga prodhuesi i paisjeve. Specialistet e larte të kenë marrëdhënie kontraktuale me ofertuesin. Kjo të vërtetohet duke paraqitur kontratën e lidhur mes tyre.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kanë nevojë për kryerjen e shërbimeve, si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik fitues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e shërbimeve me sukses.*

c) Për të vërtetuar se OE i përmbush kërkesat e Ak në specifikimet teknike duhet të paraqesi vetdeklarimet si më poshte:

- Nje deklarate që merr përsipër zevendesimin e pjesëve të këmbimit, që ato do jenë të reja origjinale ose ekuivalent dhe në përputhje me ato të përdorura fillimisht.
- Operatori ekonomik duhet të vetedeklarojë se do të bëjë mirëmbajtjen e paisjes dhe zevendesimin e pjesëve të këmbimit për ato paisje që do të kërkojë AK për periudhën 24 mujore.

Argumentimi: *Me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat/pjesët e këmbimit që do të dorëzohen të jenë të reja ose ekuivalent i tyre dhe me garanci nga prodhuesi si dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet sipas Dokumenteve të tenderit të publikuara.

Argumentim: *Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Specifikimet e publikuara në DT përshkruajnë kërkesat themelore për mirëfunksionimin e aparaturave mjekesore.